



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS KAKAVIJE



Nr. 15 / Prot

Gjirokastër, më 05/03/2024

Lenda : Kërkohet bashkëpunim

Drejtuar: Sektorit të Rikuperimit me Forcë të borxhit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

TIRANË

Në zbatim të ligjit 102/2014 date 31/07/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, udhezimin Nr 15 date 03/12/2018 “Per evidentimin kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve doganore dhe te akcizes”, me qëllim plotesimin e detyrimit për njoftimin e vendimeve të meposhtme, për efekt të vijimit të procedurave administrative.

Subjekti: “Gjergji Toromani” me NIPT: M13017206D
Vendimi : Nr.03, datë 10.01.2024
Adresa: Rruga Cërrik-Elbasan, Gjergjan, Elbasan
Detyrimi: 207,197 lekë detyrim doganor

Dega Doganore Kakavije, kërkon që të shpallet ky njoftim në faqen zyrtare të webit të Administratës Doganore Shqiptare dhe të qendroje afishimi për një periudhë 10 ditore (*vendim të cilin e gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese*).

Për përmbushje të rregullt të procedurës së njoftimit, procedura kërkon konfirmimin me shkresë, të datës së fillimit të afishimit.

Duke ju falenderuar bashkëpunimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES KAKAVIE – GJIROKASTER

Nr. 1667/Prot.
3

Gjirokaster, më, 10 / 01 / 2024

V E N D I M Nr. 3

Sot me date 10/01 / 2024, Autoriteti Vendimmarres prane Deges se Doganes Kakavije, shqyrtoi Raportin Perfundimtar të Kontrollit të mbajtur nga Grupi i Auditimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Nr.6508/9 prot, date 13.09.2023 (nr.620/6 prot, date 20.09.2023), Procesverbalin nr.1667/2 prot, date 24.11.2023 te mbajtur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr.620/7 prot, datë 03.10.2023, ne lidhje me kontrollin dhe verifikimin e deklaratës doganore Im4 me R. 11978 , date 15.07.2022; qe i perket subjektit ‘Gjergji Toromani’ me Nipt:M13017206D, adresa: Rruga Cërrik-Elbasan, Tiranë, e përfaqësuar nga agjensia doganore ‘Ujori’ me nr.J001, bashkengjitur vendimit:

OBJEKTI : Rivlerësim i deklaratës doganore

BAZA LIGJORE : Pika 2, germa b) e nenit 70 të Ligjit nr. 102/2014 ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te mesiperm :

KONSTATOVA S E

Me deklaraten doganore IM4 me R. 11978 , date 15.07.2022 subjekti ‘Gjergji Toromani’ i perfaqesuar nga Agjensia Doganore ‘Ujori’ ka realizuar procedurat doganore per artikullin 1. ‘*arra kokosi të freskëta në guackë*’, me peshë 7,757 kg, ne kodin tarifor *08011900 *, me vlerë 3,960 euro, me origjinë India, me taksë doganore 10%.

Grupi i Kontrollit prane Drejtorise se Auditimit te Brendshem në Raportin Përfundimtar të Auditimit ka evidentuar se kjo deklarate është vlerësuar me transaksion, veprim jo në përputhje me kërkesat e nenit 70, pika 3 e Kodit Doganor, pasi referuar importëve dhe deklarimeve te te njejtit artikull nga sistemi Oracle, rezulton se i njëjti artikull nga e njëjta origjinë, në këtë degë doganore, nga Sektori i Vlerës është rivlerësuar me 1.4 euro/kg NEU, për deklarimet doganore të operatorëve ekonomik në D.D.Kakavije. Mungon dokumentacioni justifikues për vlerën e transaktionit sipas nenit 66 të Kodit Doganor, pavarësisht faturës pro-formë dhe mandatit të pagesës së bankës, mungon kontrata ndërmjet palëve dhe lista e çmimeve. Subjekti nuk ka historik me të njëjtin eksportues. Për asrye se mungojnë të dhënat e disponueshme për këtë artikull, u rivlerësua artikulli sipas nenit 70, pika 2/b të Kodit Doganor, duke përdorur të dhënat

nga Database Kombëtar për produkte të ngjashme me të njëjtën origjinë, për të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin nivel tregtar. Për këtë arsye Grupi i Auditimit ka rekomanduar pagesën e detyrimeve doganore shtesë si rezultat i rivlerësimit në shumën totale prej 190,133 lekë.

Referuar konstatimit të kryer, Grupi i Punës i ngritur pranë Degës së Doganës Kakavije me Urdhërin e Brendshëm nr.620/7 prot, datë 03.10.2023 morri në shqyrtim deklaratën e sipërcituar së bashku me dokumentacionin ligjor. Në vijim të kontrollit grupi i punës arriti në konkluzionin se :

Nga shqyrtimi i deklaratës doganore rezultoi se nga Sektori i Vlerës nuk është pranuar transaksioni por është aplikuar çmimi 0.7 euro/kg, duke mos dhënë asnjë argument ku është bazuar për aplikimin e këtij çmimi. Ekziston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar, çmimit të aplikuar nga DVQ dhe çmimeve të Database Kombëtar të Vlerësimit, ku çmimi për këtë artikull nga e njëjta origjinë, për subjektet e tjera është aplikuar në vlerën 1.4 euro/kg.

Për sa më sipër Grupi i Punës ka mbajtur Procesverbalin nr. 1667/2 prot, datë 24.11.2023, duke vendosur rivlerësimin e artikullit të mësipërm me 1.4 euro/kg NEU dhe pagesën e detyrimeve shtesë në shumën totale prej 207,197 lekë.

Ne zbatim të kerkesave të nenit 273/4 të Kodit Doganor, për procesverbalin e sipërcituar subjekti është njoftuar me shkresën nr. 1667/3 prot, datë 30.11.2023 në adresën e deklaruar në QKB, ku sipas konfirmes postare nuk ka marrë dijeni.

Dega e Doganës Kakavije morri në shqyrtim dokumentacionin e mesipërm dhe pas analizës juridike të bazës ligjore, konstatimit të kryer arrin në konkluzionin se duhet të kryhet rivlerësim i deklaratës doganore sipas metodës së mallrave të ngjashëm, parashikuar nga pika 2, shkronja b) e nenit 70 të ligjit nr.102/2014 ‘Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar.

Neni 70 Metoda dytësore për vlerësimin doganor

1. *Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 66, ajo përcaktohet duke ndjekur, sipas radhës, procedurën e përmendur nga shkronja “a” deri në “ç”, të pikës 2, të këtij neni, duke u ndalur në të parën shkronjë, sipas së cilës mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave. Radha e zbatimit të shkronjave “c” dhe “ç” këmbëhet nëse këtë e kërkon deklaruesi.*

2. *Vlera doganore, sipas pikës 1, është:*

b) vlera e transaksionit e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

Per sa me siper duke u ndodhur ne kushtet e plotesimit te kerkesave te nenit 70 pika 2, shkronja b) të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise” , i ndryshuar:

V E N D O S A

1. Subjekti ‘**Gjergji Toromani**’ me Nipt;M13017206D te paguaje detyrimin doganor te papaguar ne shumen 207,197 (dyqind e shatëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) leke.
2. Jursiti të kryejë njoftimin e vendimit
3. Zyra e Finances te kryeje kontabilizimin e detyrimit.
4. Në momentin e kryerjes së pagesës Specialisti I Kontrollit Aposterior të kryejë amendimin e deklaratës.
5. Zyra Operacionale ne bashkepunim me Zyren e Borxhit te marrin masa per njoftimin e subjektit dhe rikuperimin e borxhit.

Ne baze te nenit 282 te Kodit Doganor u lind e drejta qe brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit te ankimoni kete vendim tek Drejtori i Pergjithshem i Doganave, duke paguar 100% te detyrimit doganor.

K R Y E T A R

